



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/03- 28474/22
Kaçanik, 25.10.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **VIII (tetë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 25 tetorë 2022 (e martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 13:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Arben Thaqi- OJQ. Nga Ekzekutivi i komunës në takim mori pjesë Fatmir Qaka -Kordinator për Rini dhe të Drejtat e Fëmijëve.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka, Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e VIII-të (tetë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2022, data 25 tetorë, me këtë :

REND PUNE

- 1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
- 2.Aktivitetet rinore në komunën e Kaçanikut; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete.

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka, A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverballi ? Procesverballi i mbledhjes se VII-të (shtatë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2022, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes se VII-të (shtatë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2022, të datës 27.09.2022 / Lënda : 01Nr. 60/01-25550/22.

2. Aktivitet rinore në komunën e Kaçanikut;

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: e hapi diskutimin për pikën e aktiviteteve rinore.

z. Arben Thaqi: Unë jam pjesë e shumë aktiviteteve rinore, por siç e dimë të gjithë që për realizimin e këtyre aktiviteteve duhet një buxhet i mjaftueshëm apo subvencione për shkak se projektet e tilla kanë kostot e tyre të shpenzimeve.

Ajo që mua më brengos dhe më ka penguar gjithmonë ka qenë, jo vetëm çështja e subvencioneve, por mjetet që janë ndare nga buxheti komunal asnjëherë nuk kanë qenë të mjaftueshme për rininë e konkretisht për aktivitetet rinore. Shumë prej aktiviteteve nuk kanë mundur të organizohen mirë, e disa në mënyrë simbolike, gjë e cila është për tu shqetësuar për shkak se çdo aktivitet për të arritur një qëllim duhet me pas një kohëzgjatje jo formale, me qëllim që pjesëmarrësit të jenë të kënaqur me aktivitetin që e bëjnë. Andaj ky formalitet i organizimit të aktiviteteve rinore duhet të ndryshojë, mos të jetë simbolik por të arrihet efekti pozitiv në komunitet.

Sa i përket aktiviteteve kulturore dhe sportive kam vërejtur disa prej tyre, por nuk kam parë ndonjë gjallëri, andaj duhet të punojmë më shumë në këtë drejtim në mënyrë që të zgjojë edhe më shumë kureshtje nga njerëzit, pasi që tani edhe kushtet janë më të mira për shkak se posedojmë palestra sportive, dhe motoja e kësaj është “Ta ruajmë rinin e mos ti ruajmë sallat sportive”, me qëllim që rininë tonë ti largojmë nga dukuritë negative por edhe nga rrjetet sociale të cilat janë shumë të dëmshme për ta!

z. Fatmir Qaka: Siç jeni të njoftuar drejtorja për kulturë rini dhe sport, në kuadër të kompetencave, në fillim të vitit i qet subvencionet për kategorinë e rinisë, ku aty aplikojnë grupet rinore, shoqatat sportive dhe shoqëritë kulturo artistike.

Në kuadër të sektorit të rinisë janë dy organizata që veprojnë në komunën tonë si: BONEVET dhe KVRL.

KVRL, është këshilli i veprimit rinor lokal, një OJQ e cila dallon nga OJQ-të e tjera për shkak se KVRL-të janë të themeluara nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe komuna, që d.m.th. kanë një status të veçantë në raport me OJQ-të e tjera, pra komuna e ka obligative sigurimin e objektit, vendin ku ato veprojnë, me zyre gjenden në shtëpinë e kulturës. Tani ata kanë aplikuar me fondin që posedojmë në vlerë prej 70 mijë euro, ku KVRL i ka mjete në vlerë prej 1500 euro për aktivitet e tërë vitit, ndërsa OJQ-BONEVET, ka mjete në vlerë prej 2 mijë euro.

OJQ-të, grupet rinore dhe OJQ-të rinore, duhet patjetër me i përcjell programin e sekrorit për rini kulturë dhe sport, në mënyrë që ti përshtaten plan programit të drejtorisë për kulturë dhe sport dhe të aplikojnë për projekte.

KVRL-ja e ka plan programin e saj edhe aktivitet që i realizon në kuadër të komunës por i ka edhe aktivitetet e veçanta por që janë në kuadër të programit për kulturë rini dhe sport duke filluar me aktivitetet si dita ndërkombëtare e tokës (22 prilli), gara letrare, mandej dita ndërkombëtare e librit (23 prilli) e cila shënohet rregullisht, një qershori dita ndërkombëtare e fëmijëve, si dhe aktivitetet përcjellëse të komunës, si dita e dëshmorëve dhe dita e çlirimit të komunës së Kaçanikut.

Aktiviteti më i rëndësishëm dhe më i madh që e organizojnë është Java e rinisë në Komunën e Kaçanikut (19 shtatori) e cila organizohet në mënyrë tradicionale prej vitit 2006.

Në bazë të buxhetit në vlerë prej 70 mijë euro, të ndara në programin e rinisë, kulturë dhe sport, shuma që ndahet për këto aktivitete është shumë modeste, mirëpo krahas saj ka edhe aktivitete të tjera që organizohen me organizata të tjera ndërkombëtare siç është USAID dhe Banka Botërore.

Është me rëndësi të theksohet se Komuna e Kaçanikut, ka qenë në mesin e dhjetë komunave përfutuese të projektit "Komuna për të rinj" e financuar nga Banka Botërore dhe Qeveria Japoneze, të cilat kanë ndarë mjete në vlerë prej 180 mijë euro me bashkëfinancim nga komuna prej 15 % pjesëmarrje në financim të projektit.

Jemi në fazën e parë të implementimit të projektit "Komuna për të rinj", ku gjithsej janë 6 përfutues, 5 përfutues nga 15 mijë dollarë dhe një përfutues 4 mijë dollarë ku përfutues është grupi jo formal i të rinjve nën moshën 18 vjeç, kurse grupet tjera përfshijnë moshat mbi 18 vjeç.


z. Arben Thaqi: Për aktivitet që u ceken nga kolegu Fatmir, unë në cilësinë e përfaqësuesit të OJQ-së, asnjëherë nuk kam pasur asnjë ftesë konkretisht për këto subvencionet që janë dhënë nga Qeveria Japoneze, andaj kërkojë nga ju që të ftohen në ndonjë takim të gjithë OJQ-të e komunës së Kaçanikut, në mënyrë që të njoftohemi mbi mundësinë e tërheqjes së mjeteve për organizimin e aktiviteteve rinore.

z. Fatmir Qaka: Sa i përket aplikimit lidhur me projektin Komuna për të rinj, thirrja ka qenë e hapur, ku kanë mundur të aplikojnë moshat 16-18 vjeç dhe moshat 18-24 vjeç.

3. Të ndryshme:

Kryesues i Komitetit: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme ? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 13:40.

Procesmbajtës
Mavije Murseli



Kryesues i Komitetit
Ekrem Livoreka

